



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KREUT TË PREZENCËS – CEREMONIA E DIPLOMIT PËR
PROJEKTIN “GRATË NË QEVERISJE” - 16 QERSHOR 2009**

[Fjala hapëse]

Z. President, Shkëlqesi, Zonja zëvendësministre, Zonja dhe Zotërinj, mirmëngjes!

Në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ju uroj mirëseardhjen në ceremoninë e diplomimit për fazën e parë të Projektit “Gratë në Qeverisje”

Është nder i madh për Prezencën të mblidhemi sot nga shkëlqesia tije Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Profesor Dr. Bamir Topi, i cili pati mirësinë që jo vetëm të na drejtohet me fjalën e tij, por edhe të përshëndesë dhe t’u shpërndajë certifikatat të gjithë pjesëmarrëseve.

U uroj mirëseardhjen anëtarëve të Bordit Këshillimor të Projektit, zëvendësministres Znj. Marieta Zaçe, dhe anëtareve të parlamentit Znj. Lajla Pernaska dhe Znj. Diana Çuli.

I uroj gjithashtu mirëseardhjen Ambasadorit të Mbretërisë së Hollandës z. Henk G.C. van den Dool, dhe të ngarkuarës së përkohshme me punë të Ambasadës së Suedisë në Tiranë, Znj. Elisabeth Stam.

Pa mbështetjen financiare të të cilëve ky projekt nuk do të kishte mundësi të realizohej.

Së fundi, por absolutisht jo më pak e rëndësishme, u urojmë mirëseardhjen të gjitha pjesëmarrëseve të projektit të cilat janë mbledhur këtu.

Duke ardhur nga çdo anë e Shqipërisë, ato kanë treguar një energji të pashtershme dhe një angazhim të patundur për t’u përfshirë në jetën politike të këtij vendi dhe për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të të drejtave të grave.

Ky projekt përbën pjesën e parë të programit trevjeçar *Rritja e Rolit të Grave në Qeverisje*.

Më vonë do të ndjekim një prezantim të shkurtër të të gjitha veprimtarive të kryera.

Tani kam kënaqësinë e veçantë të ftoj shkëlqesinë e tij, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Z. Bamir Topi, të na drejtohet me fjalën e tij.

[Fjala mbyllëse]

Z. President, shkëlqesi, zonja zëvendësministre, zonja dhe zotërinj.

Siç e dëgjuam sot këtu, zvogëlimi i hendekut në barazinë gjinore në të gjitha nivelet e qeverisë dhe strukturat më të gjera politike, mbetet një çështje e rëndësishme.

Mbushja e këtij hendeku mbetet një çështje për të cilën të gjithë ne kemi përgjegjësi të japin ndihmesën tonë.

Vetëm pas 12 ditësh, në këtë vend do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare të cilat do të kenë efekt të drejtpërdrejtë dhe afatgjatë për ambiciet e këtij vendi drejt integritimit.

Do të jetë pikërisht kjo ditë kur ne do të jemi në gjendje të vlerësojmë se sa të suksesshme do të jenë këto zgjedhje për fuqizimin e mëtejshëm të grave në Shqipëri.

Do të jemi në gjendje të vlerësojmë nëse kuotat gjinore të parashikuara në Kodin Zgjedhor do të rezultojnë vërtetë në një rritje të konsiderueshme të numrit të grave deputete.

Gjithashtu, do të jemi në gjendje të vlerësojmë se sa do të jetë numri i grave që shkojnë në votime dhe deri në çfarë mase do të jenë ato në gjendje të shprehin të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar në mënyrë individuale dhe të fshehtë dhe pa fenomenin e errët të presionit të jashtëm, i njohur si *votimi familjar*.

Justifikimi i kësaj sjelljeje duke e etiketuar thjesht si pjesë e “kulturës shqiptare” nuk vlen më për vitin 2009.

Faktorët politikë shqiptarë duhet të tregojnë se janë seriozë në arritjen e ambicioneve të tyre të integritimit, sidomos tani si një shtet anëtar i NATO-s, e duhet të dalin me një qëndrim publik të patundur për të dënuar një sjellje të tillë ndaj grave në ditën e zgjedhjeve.

Autoritetet e administrimit të zgjedhjeve kanë një përgjegjësi të qartë për të parandaluar kryerjen e veprimeve të tilla në ditën e zgjedhjeve.

Të biem dakord që në zgjedhjet parlamentare shqiptare të viti 2009, populli shqiptar do ta hedhë tej fenomenin e shëmtuar të votimit familjar në koshin e plehrave të historisë së politikës, aty ku e ka vendin dhe do të votojë sipas zgjedhjes së vet.

Tani le të presim me kënaqësi datën 28 qershor, kur të gjithë shqiptarët do të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të vendosur se kush do ta udhëheqë vendin e tyre gjatë katër viteve të ardhshme.

Të presim një fushatë zgjedhore ku të gjitha partitë politike të jenë në gjendje të paraqesin programet dhe vlerat e tyre në mënyrë të hapur, të lirë dhe transparente.

Le të shpresojmë që këto zgjedhje të arrijnë standardet e kerkuara, ku vlerat e popullit shqiptar përkthehen në mënyrë të saktë e të ndershme në vende në parlament.

Se fundi, ne kuader të vendimit të djeshëm për të shtyrë afatin e aplikimit për kartat e identitetit, unë ju bëj thirrje të gjithë qytetarëve që nuk zoterojnë një letërnjoftim të vlefshëm që të shkojnë dhe të aplikojnë, dhe gjithë atyre që kanë aplikuar tashme, që të shkojnë dhe të terheqin kartat e tyre – nuk ka kohe për të humbur.

Z. President, shkëlqesi, zona zëvendësministre, zonja dhe zotërinj, e mbyll këtë ceremoni duke ju falënderuar edhe një herë që ishit me ne këtë mëngjes.

